



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 2642/8 Prot.

Pogradec, më 30.06 2026

VENDIM

Nr. 87, DATË 29.06.2026

PËR

**“PËRDORIMIN PËR NEVOJAT E ENTEVE TË BASHKISË TË SASISË SË
MATERIALIT DRUSOR TË SEKUESTRUAR”**

Të nderuar këshilltarë !

Në mbështetje të; pikes 2 të nenit 8, pike 5 të nenit 27 të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendor”, Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligjit Nr.57/2020, “Për Pyjet”, Vendimit të Këshillit të Ministrave VKM Nr.438, datë 08.06.2016 “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore dhe jo pyjore”, Ligjit Nr.10296, date 08/07/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” (i ndryshuar), Ligjit Nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, si dhe Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësinë e sektorit publik”. Bashkia Pogradec me propozim të Kryetarit të Bashkisë dhe Agjencia e Mbrojtjes së Territorit (Inspektoriati i Shërbimit Kontrollit Dhe Mbrojtjes së Pyjeve dhe Kullovave), pasi u shqyrtua relacioni i përgatitur nga Administrata e Bashkisë ku është argumentuar teknikisht dhe ligjërish, i kërkohet Këshillit Bashkiak të Bashkisë Pogradec që në mbledhjen e datës 29.06.2026 të miratojë:

VENDOSI:

1. Të miratojë përdorimin e sasisë së materialit drusor prej 290 mst të llojit pyjor Ah dhe Lis për plotësimin e nevojave me dru zjarri entet Publike (Shkolla, Kopshte, Çerdhe etj), si dhe 8.4 m³ lëndë punimi e cila do ti nënshtrohet procedurave të prokurimit publik (Ankand).



2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Pogradec, Agjencia e Mbrojtjes së Territorit (Inspektoriati i Shërbimit Kontrollit Dhe Mbrojtjes së Pyjeve dhe Kullotave), Drejtoria e Çështjeve Juridike, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiare.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
4. U shpall sot më datë 29.06.2026.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI



1.Miratur me 18 vota
2.Vota Pro 18
3.Vota Kundër 0
4.Vota Abstenim 1
5.Zbardhur më date 29.06.2026